



KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-03/08

Më datën 14.02.2018

Bazuar në nenin 43, paragrafi 1, të Ligjit, Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28”), nenin 33 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Suharekë;

Për datën 23.02.2018

Ora 13⁰⁰

CAKTON

Mbledhjen e 3, (tretë) të rregullt për vitin 2018, të Kuvendit të Komunës në Suharekë, dhe njëherit propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB);**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal i aksionarëve;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisioni për shqyrtimin e ankesave;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2017, të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. me seli në Suharekë;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2016 dhe 2017, të përcillen për shfrytëzim në vitin 2018;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

Mbledhja mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Suharekë.

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI



KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
 SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
 MUNICIPALITY OF SUHAREKA

PROCESVERBAL II/2018

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) të rregullt për vitin 2018 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 31.01.2018
Ora : 13.00

Prezentë në takim:

z. Nexhat Ramadani
 z. Bashkim Ndrecaj
 z. Ardian Shala
 z. Alban Berisha
 z. Shefket Kolgeci
 z. Xhemajl Kabashaj
 znj. Elmaze Kabashi
 znj. Bulëza Kuçi
 znj. Shqipe Ramaj
 z. Sali Bytyqi
 z. Reshat Selimaj
 z. Shefket Kuçi
 z. Bexhet Kuçi
 z. Aziz Bytyqi
 z. Gazmend Gashi
 znj. Besa Kuçi
 znj. Mirlinda Muqa
 znj. Vlora Neziri

z. Rilind Krasniqi
 z. Jeton Rakaqi
 z. Arbërim Basha
 z. Dardan Berisha
 znj. Marigona Gashi
 znj. Florie Bytyçi
 z. Sami Hajdari
 znj. Albana Bytyqi
 z. Osman Selimaj
 z. Leonard Shala
 z. Dugagjin Palushi
 znj. Laureta Tafaj
 z. Gëzim Kryeziu

Të pranishëm të tjerë
 Kryetari Komunës
 Medjat dhe qytetarë
 OSCE, LMT, KDI
 Habibe Bytyqi
 Xheladin Sadikaj, etj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar;**
2. **Shqyrtim i projekt vendimit për shpallje „Qytetar nderi” Komunës së Suharekës;**
3. **Shqyrtimi i projekt vendimit për formimin e komisionit për zbatimin procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
4. **Shqyrtim i projekt vendimit për emërimin e këshillit organizativ për kremtimin e „17 shkurtit” ditës së shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, „13 Qershorit” ditës së Çlirimit të Suharekës dhe „Festarit”;**
5. **Shqyrtim i projekt vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave që paraqiten kundër vendimeve të komisionit për ndarjen e bursave;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-Plotësimin e vendimit 01-Nr-013-216, të datës 15.01.2018;**
7. **Shqyrtimi i projekt vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës;**
8. **Të ndryshme;**

Kryesuesi - i përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi me këtë rend dite dhe i njofton për anëtarin e ri të asamblesë Gazmend Gashin i cili do ta jap betimin dhe për vendimin e ministrisë lokale që ka të bëjë me KPF-në se e njëjta duhet të ketë barazi gjinore

Aprovohet rendi i ditës

Pika e parë - Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar

Ardian Shala – kam vërejtje unë e kam lexua biografin e anëtarit që kemi propozua për kryesues e këtu nuk është.

Aprovohet me vërejtje

Pika e dytë - Shqyrtim i projekt vendimit për shpallje „Qytetar nderi” Komunës së Suharekës

Kryetari – njofton asamblistët se e ka propozua Talat Xhaferin kryetarin e parlamentit të Maqedonisë për ta shpall qytetar nderi të Suharekës.

Leonard Shala – jemi pro për Talat Xhaferin por kamë sugjerim që në të ardhmen të propozohet ai i cili ka kontribuar për Suharekën.

Ardian Shala – Edhe se i njëjti ka merita të veganta është kryetar i parlamentit të Maqedonisë por për Suharekën nuk ka dhënë kontribut dhe ne si grup i LDK-së abstenojmë.

Jeton Rakaqi – ne si PDK e përkrahim këtë propozim për qytetar nderi.

Reshat Selimaj – cila është kjo në dëm të qytetit , kryetar është ai që do të shpallet.

Ardian Shala – sa i përket atyre të më pasme janë politike, unë thash se për Suharekën s'ka dhanë kurrfarë kontributi.

Sali Bytyqi - fjala është për një njeri të madh ku ne si një shtet me shumë kombësi, si shqiptar është kryetar i kuvendit, Talat Xhaferi është një njeri që meriton se ka dhënë shumë për shqiptari.

Xhemajli Kabashaj – ne nuk jemi që mos të ja njohim meritat e Xhaferit por dua të shoh kontributet që ka dhënë për Suharekën.

Rilind Krasniqi – unë si qytetarë jam ndier mirë kur është zgjedhur kryeparlamentar.

**Me 21 vota për e
8 abstenime aprovohet**

Pika e tretë - Shqyrtimi i projekt vendimit për formimin e komisionit për zbatimin procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës

Avni Bytyqi – bën elaborimin e projekt vendimit.

Leonard Shala – pasi që është paraparë që komisioni të jetë me shtat anëtar mendoj që mund të propozohen nga krejt partitë politike.

Ardian Shala – e përkrah propozimin e leopardit dhe ne si **LDK propozojm Xhemajl Kabashin**
PDK – Marigona Gashi
AAK- Besa Kuçi
Shoqris civile – Antigona Kolgeci

**Me 26 vota për e
3 kundër aprovohet**

Pika e katërt - Shqyrtim i projekt vendimit për emërimin e këshillit organizativ për kremtimin e „17 shkurtit“ ditës së shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, „13 Qershorit“ ditës së Çlirimit të Suharekës dhe „Festarit“

Nga LDK-ja propozohet - Nexhat Ramadani
Nga PDK-ja propozohet – Rilind Krasniqi
Nga Nisma propozohet – Albana Bytyqi
Nga VV-ja propozohet – Dugagjin Palushi

Ardian Shala – pyet për një shil që është formua

Alban Berisha – ne nuk jemi sa me than diçka por në vebfaqe të Komunës është një këshill i formuar nga kryetari dhe një tash nga kuvendi.

Kryetari – ajo është këshilli i artistëve.

Leonard Shala – në nenin 2 thotë këshilli ka të drejt përgatitjen e skenës, kështu mirë është këtu të jetë drejtoria e kulturës.

Avni Bytyqi – jep sqarime mbi funksionin e dy këshillave.

Ardian Shala – mos të veprohet me dualizëm.

Aprovohet unanimitisht

Pika e pestë - Shqyrtim i projekt vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave që paraqiten kundër vendimeve të komisionit për ndarjen e bursave

Dugagjin Palushi – edhe unë si Leonardi kërkaj të përfshihen edhe partitë më të vogla.

LDK – Bulza Morina
AAK - Aziz Bytyqi
PDK – Dardan Berisha
Nisma – Alban Bytyqi
VV - Laureta Tafaj

Aprovohet unanimitisht

Pika e gjashtë - Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-Plotësimin e vendimit 01-Nr-013-216, të datës 15.01.2018

Kryesusi – ka të bëjë me komitetin për komunitete ku ne vend të Denis Sofrës shkon Naazim Shabanaj ku zyrtari ligjor ju sqaron arsyen se pse është bërë ky ndryshim.

**Me 28 për dhe
Ne 8 kundër aprovohet**

Kryesusi – bëhet ndryshimi i vendimit të Komitetit për politik dhe finance për shkak se nuk ka barazi gjinore që e njëjta është kthyer nga ministria e pushtetit lokal.

Reshat Selimaj – unë tërhiqem nga ky komitet dhe e propozoj Vlora Neziri.

Ardian Shala – ne pe japim emrin e kandidatit Shqipe Ramaj ndërsa takimin e ardhshëm njoftojmë se kush po tërhiqet.

Pika e shtatë - Shqyrtimi i projekt vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës

Kryesusi – pasi që në takimin e kaluar nuk ka kalua ky projekt vendim kështu e kemi pru sot .

Kryetari – jep sqarime se për se ka aradhe në asamble ky buxhet prapë për tu votua dhe për ndryshimet që janë bë në projektet kapitale.

Ardian Shala – në bazë të ligjit shihet se nga mos votimi i asamblistëve në shtator kemi një humbje bukur të mirë të buxhetit nga mos votimi i opozitës nga kjo shihet se është dëmtuar buxheti i komunës i përmend edhe ndarjen e subvencione, çdo herë ka pas vërejtje për mos konkretizimin e projekteve ku prapë ka plot projekte të pa konkretizuara i përmend edhe disa projekte që janë hekë e që kanë qen si prioritet.

Kryetari – jep sqarime se pse janë hekë ato projekte.

Jeton Rakaqi – takimin e më parshim nuk është votua se nuk jeni konsultuar me opozitën por e keni përpilua politikisht edhe politikisht nuk e kemi votua, jep edhe vërejtje te projektet që nuk janë specifiku.

Kryetari – jep sqarime për pyetjet e parafolësin dhe buxhetin për vitin 2019 do ta bëj opozita.

Bashkim Ndrecaj – projektin e Shirokës për trotuare e keni hekë e keni qu ministri e pse të shkoj në ministri kur ajo kushton vetëm 2.000€ , mendoj se trotuaret janë më të rëndësishëm se rrugët e arave, jep vërejtje edhe për rrugën Maqitev, Shirokën e ke përjashtua krejt Dobërdelanin krejt dhe rrugët e arave të cekën me emra.

Kryetari - jep sqarime për vërejtjet e parafolësit.

Dugagjin Palushi – Budakovë ka qenë një projekt për furnizim me ujë 70.000€ e të cilat janë hekë e neve na vyen uji, ne me hidreregjionin i kemi ba matjet në rajonin e Budakovës ka kohë që kemi bisedua edhe me kryesin e fshatit, kanë qen edhe 2 rrugë të parapara të cilat janë hekë, cek edhe disa projekte të pa specifikuara a do ketë ndryshim buxheti.

Kryetari – jep sqarime për heqjen e 2 projekteve Budakov ndërsa sa i përket për ujë ki me pas përkrahjen.

Laureta Tafaj – kërkoj sqarim nga kryetari për rrethojat e varrezave në Vraniq dhe fondi emergjent për qka është.

Kryetari - jep sqarime.

Dardan Berisha – projektet në Gjinoc janë projekte prioritare ndërsa e keni hjek, te subvencionet e drejtorisë kulturës nuk shoh ndihma për grupe sportive dhe në arsim nuk shoh ndryshime që do të bëj ndryshime në efikasitet.

Kryetari – jep sqarime pyetjeve të parafolësit.

Leonard Shala – ky plan është që nuk ka kalua me kohë jep arsyeën pse nuk e ka votua dhe se nëse tash do të votojnë arsyeja se vetëm 10% do të hiqet dhe pyet kryetarin për bazenin Biraç pse nuk kanë nda buxhet.

Kryetari – jep sqarime për pyetjet e parafolësit dhe i njofton për disa projekte të cilat i ka qu në qeveri.

Reshat Selimaj – jep arsyetim pse se ka votua takimin e më parshim, ka qen e paraparë rruga Haxhi Jusufi dhe tash nuk është pse dhe kërkon të votohet me ndryshime.

Xhemajli Kabashaj – drejtorja e bujqësisë ka ulje buxhet edhe se ka pas nevojë për rritje, njofton për realizimin e projekteve më herët ato të serave, shtallave dhe jep vërejtje për pjekjen e disa linjave buxhetore, pyet kryetarin për 2 projekte që kanë qen me bashkëfinancim të cilat janë procedua, pyet edhe për disa projekte tjera.

Kryetari – që në fillim ju tregove për heqjen e 10% dhe këto janë ato zvogëlime nga projektet.

Xhemajli Kabashaj – 170.000 ku do të shkojnë se janë pa definuar.

Kryetari – ato janë për rrugë të arave.

Rilind Krasniqi – kërkon të afrohen kushte më të mira sallën e asambles se është ftoftë të ketë ulëse edhe për persona me aftësi të kufizuar, banjat në shkollën Studenqan, rruga për te varrezat e Stuguqanit rruga Kosova kërkoj këto të ndërtohen se janë urgjent.

Kryetari - i përgjigjet kërkesave të parafolësit.

Flori Bytyqi – unë pajtohem me parafolësin për kushtet e sallës së asamblesë, te sanimi dhe renovimi i QKMF-ve dhe QMF çka ka mu meremetua, blerja e mjeteve cilave mjete kërkoj konkretizim të projekteve kapitale, nuk është e paraparë asnjë projekt për çerdhe.

Kryetari – i përgjigjet pyetjeve të parafolëses dhe i tregon se ku i ka parapa ndërtimin e çerdheve.

Shefket Kolgaci – pasi që u përmend fshati im për ujë Vraniqi i njoftoj me arsyeën dhe shkaqet pse s'është bë.

Elmaze Bytyqi – pyet për çerdhe dhe 2 projekte për fshatin Nishor pse janë hekë.

Shefket Kuçi – Suharekë propozoj një rreth rrotullim te rruga Skënderbeu dhe një nënkalim te shkolla Dastan Bajraktari.

**Me 21 për dhe
8 kundër dhe 1 abstenim
aprovohet**

Takimi përfundoi në ora 16,05

**Proces mbajtësi
Hilmije Sahitaj**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 9 pika 3, lidhur me pikën 4, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.35/2012”, nenit 3, të Rregullores QRK Nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miratoj këtë:

Projekt-V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, **pas** procesit te vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, për periudhën afatshkurt dhe afatgjatë.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbehet prej 3, (tre) anëtarëve dhe do të ketë përbërje:

1. -----anëtar-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
2. -----anëtare-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
3. -----anëtar-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjnë shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit te vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, për periudhën afatshkurt apo afatgjatë, ku komisioni lidhur me ankimin vendosi me vendim në këtë mënyrë;

- 3.1 **refuzimin e ankesës** dhe lënia në fuqi të procesit të vlerësimit final të ofertës
- 3.2 **miratimin e ankesës** dhe shfuqizimin, revokimin e procesit të vlerësimit final të ofertës.

Neni 4

Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës në Suharekë.

Neni 5

5.1 Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

5.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr. 01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-16-1190, i datës 24.02.2014, mbi formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë _____

Kryesuesi Kuvendit

Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), te Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 7, të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 19/2012”, neneve 15, 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, dhe nenit 3, paragrafi 2, nenit 4, lidhur me nenin 9, paragrafi 1, pika 2, të Udhëzimit Administrativ, Nr.27/2012, të lëshuar nga MPB-ja dhe Nr.03/2012, të lëshuar nga MAPL-ja me datën 22.08.2012, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoj këtë:

Projekt-V E N D I M
Për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSb)

Neni 1

Me këtë vendim themelohet këshilli komunal për siguri në bashkësi (KKSb) me këtë përbërje të re:

1. Bali Muharremaj.....Kryetar i Komunës.....kryesues
2. Milazim Lumi.....Komandant i Policisë.....anëtar
3. Halim Shehu.....Përfaqësues i Komunitetit Islam.....anëtar
4. Mikel Sopi.....Përfaqësues i Komunitetit Katolik.....anëtar
5. Remzi Bytyqi.....Drejtor i Drejtorisë së arsimit.....anëtar
6. Habibe Bytyqi.....Zyrtare për barazi gjinore.....anëtare
7. Enver Shabani.....Sektori i Emergjencës.....anëtar
8. Isak Dermiri.....Përfaqësues i FSK-së.....anëtar
9. Fetije Bytyqi.....Përfaqësuese e KLSP-së.....anëtare
10. Adem Derguti.....Kryetari i KPAK-së.....anëtar
11. Astrit Bytyqi.....Përfaqësues i OJQ-së.....anëtar
12. Barahim Thaqi.....Përfaqësuese e mediave lokale.....anëtar
13. Shaqir Palushi.....Përfaqësues komuniteti i biznesit.....anëtar
14. Xheladin Sadikaj.....Përfaqësues i zyrës KKK-së.....anëtar
15. Shkëndije Shabanaj.....Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li.....anëtare
16. Hanife Bytyqi.....Përfaqësuese e KPAK-së.....anëtare
17. Zekë Berisha.....Përfaqësues i Romëve.....anëtar
18. Antijona Sofra..... Përfaqësues i Egjiptas.....anëtare

Neni 2

Detyrat, përgjegjësit, funksioni, mandati dhe kompensimi i këshillit komunal për siguri në bashkësi janë të përcaktuara në udhëzimin administrativ me numër Nr.27/2012, të lëshuar nga MPB-ja dhe Nr.03/2012, të lëshuar nga MAPL-ja me datën 22.08.2012.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-16-1189, i datës 24.02.2014, për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI

01-Nr-16-_____
Me datë _____



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), te Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 5, të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008” dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, e në mbështetje të neneve 15, 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoj këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Suharekës për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Stacionin e Autobusëve” Sh.A, me këtë përbërje të re:

1. -----, i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar/e
2. -----, i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar/e
3. -----, i emëruara nga Kryetari Komunës-----anëtar/e

Neni 2

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008) dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012) dhe më Ligjin Nr-02/L-123, për Shoqëritë Tregtare, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 39/2008” dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

Neni 3

Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacionin e Autobusëve” Sh.A, me seli në Suharekë.

Neni 4

4.1 Mandat i anëtareve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-16-1188, i datës 24.02.2014, për formimin e komisioni komunal i aksionarëve.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY-SUHAREKË-
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, të nenit 8, paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-087 për ndërmarrjet publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më, -----, miratoj këtë

Projekt-V E N D I M

Për miratimin e raportit për vitin 2017, të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A.

Neni 1

Miratohet raporti për vitin 2017 i performancës së Komisionit komunal të aksionarëve për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisive në NPL “Stacioni i autobusëve” SH.A. me seli në Suharekë.

Neni 2

Raporti i cekur në neni 1, të këtij vendimi është shqyrtuar dhe miratuar në pajtim me dispozitat e nenit 8, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmarrjet publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendim është raporti 01-Nr-016-5186 i datës 03.02.2018, i përgatitur nga anëtarët e Komisionit Komunal i Aksionarëve.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr-_____

Me datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-28/2008, dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-27/2008, nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë,----- miratoj këtë:

Projekt -V E N D I M

Për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2016 dhe 2017, të përcillën për shfrytëzim në vitin 2018.

Neni 1

Mjetet vetanake të realizuara në vitin 2016 si dhe mjetet vetanake të vitit 2017 të pa shpenzuara të bartën për shfrytëzim në vitin fiskal 2018.

Neni 2

A). Bartja e mjeteve vetanake të pa shpenzuara të vitit 2016 dhe 2017 në shumë prej **694,931.46** € të bartën në vitin **2018**, dhe të lejohen për alokim dhe shpenzim në këto programe dhe kategori ekonomike të caktuara si në vijim:

Tabela1.

Buxheti për batje sipas njësive buxhetore dhe kategorive ekonomike

	Mallra& Shërbime	Komunali	Subven cione	Invsti.Kapitale	TOTAL:
Zyra e Kryetarit (16012)	147.07			-	147.07
Administrata (16312)		7,446.43		5,740.64	13,187.07
Zyra e Kuvendit (16912)		904.46			904.46
Inspekcioni (16623)				4,580.00	4,580.00
Buxheti dhe Financa(17512)	1,750.45				1,750.45
Shërbimet Publike dhe Emergjente (18012)	610.06	559.77		567,926.80	569,096.63
Bujqësia e Zhv.Rural(47012)	2,184.32			4,962.61	7,146.93
Kadastër & gjeodezi(65060)	260.10				260.10
Planifikim e Urbanizëm (66365)	1,320.00			35,029.07	36,349.07
Administratë e Shëndetësisë (73021)	3,024.00		1,559.00		4,583.00
Shëndeti primar-QKMF (73750)	17,000.00			679.23	17,679.23
Shërbimet Sociale (75556)	930.00				930.00
Kulturë Rini e Sport (85012)	1,119.85			15,059.08	16,178.93
Administrata- Arsimit (92060)	670.06	2,287.71	1,039.00	15,642.87	19,639.64
Arsimi parafillor (92430)	69.70	1,983.25			2,052.95
Arsimi i mesëm (94530)	4.58	441.35			445.93
TOTAL:	29,090.19	13,622.97	2,598.00	649,620.30	694,931.46

Tabela 2. Projektet kalitale sipas njesive buxhetore per bartje nga fondi burimor(21+22) në vitin 2018

16623 INSPEKSIONI-SUHAREKË	4,580.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	4,580.00
40873 RRENIMI DHE TRAJT.OBJE.PA LEJE	4580.00
16312 ADMINISTRATA-SUHAREKE	5,740.64
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,740.64
87963 MIRMBAJTJA E OBJEKTEVE INSTITUCIONALE	5,740.64
16623 INSPEKSIONI-SUHAREK	4,580.07
30 PASURITË JOFINANCIARE	4,580.07
40873 RRËNIMI DHE TRAJTIMI I OBJEKTEVE PA LEJE	4,580.07
18012 SHERB.PUBLI-INFR.RRUG-SUHAREKË	567,926.80
30 PASURITË JOFINANCIARE	567,926.80
40892 PASTRIMI DHE RREGULLIMI I LUMENJEVE NE KOMUNE	30,000.00
40911 ELEMENIMI I DEPONIVE ILEGALE	7,363.70
40919 RREGULLIMI I SHTRATIT TE LUMIT NE MUSHTISHT	30,000.00
43524 TRAJTIMI I UJRAVE ATMOSFERIK NE RRUGEN XHAVIT SYLAJ	20,487.00
43533 RREGULLIMI I TROTUARIT NE TERRNJE	15,000.00
44505 SANIMI DHE MIRMBAJTJA E RRUGEVE LOKALE	30,090.00
44507 TROTUARI NE RR "MAN SALLAUKA" BUDAKOVE	3,002.12
44508 NDERTIMI I RRUGEVE "NURE RAMADANI" DHE "BRAHAJT NE NISHOR	9,422.00
44533 NDER.RR. "MULLIRI DESTANIT, KULLOS. NAZIF GASHI" STUDENQAN	3,199.48
44535 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE " S. KURTISHAJ, H. KURTISHAJ, CANA	5,000.00
44537 NDER.RR."SAHIT TIXHAJ, SHTABI USHT. MATI/ XHERAVICA BLLACE	8,350.00
44541 RREGULLIMI I VARREZAVE NE REQAN	12,000.00
44560 NDERTIMI I KANALIZIMIT NE DRAGAQINE	20,000.00
44565 NDERTIMI I RRUGES "HAMEZ BAJRAMI" NE MAQITEVE	25,000.00
44566 NDERTIMI I KANALIZIMIT LUZHNIÇE	15,000.00
44570 NDER. URES MBI LUMIN TOPLLUHA KANALIT TE UJIT NE SAMADRAXH	5,000.00
44577 RREGULLIMI I HAPSIRAVE PUBLIKE NE GJINOC	10,000.00
44579 NDERTIMI I KANALIZIMIT NE FSHATIN DVORAN	15,000.00
44582 RREGULL. HAPS. PUB. VARR. TE UKE BYTYÇIT NE SEMETISHT	10,000.00
44855 NDER.RR. LUIGJ NIKOLLA, AVDYL KUÇI RR.STADIUMI NE SUHAREKE	10,000.00
44859 ZGJIDHJA E KRYQEZIM. TE RR.TE SHTEPIA KULTURES NE SUHAREKE	2,710.00
44877 RREGULLIMI I PRROCKES DHE HAPSIRE PUBLIKE NE VRANIQ	5,000.00
44954 NDER.RR.JETISH LIMANI,FAIK SELIMI,BAFTI KRASNIQI TROT.DUBRAV	10,000.00
44985 NDER.RR. "NENTORI I DYTE DHE MRIZI I ZANAVE" NE RESHTAN	10,000.00
45091 EKSPROPRIJIMI NDERTIMI I KANALIT TE UJITJESE NE MUSHTISHT	18,870.00
45379 NDERTIMI I RRUGES "ISUF META" NE JAVOR	4,053.80
45541 NDERTIMI I REZERVARIT TE UJESJELLSIT NE PEQAN	19,727.66

45615 TRASIMI I RRUGES KASTERC-BRESHANC	10,000.00
45932 NDERTIMI I RRUGES "HAXHI QERIMI" DHE "HAJDARET" NE BAQEVIC	4,389.51
85696 FONDI EMERGJENT	18,148.56
85704 MIRBAJTJA DHE PASTRIMI QYTETIT	13,788.85
85706 MBIKQYRJA PROJEKTEVE INVESTIVE	10,000.00
87980 INSTALIMI DHE SANIMI I NDRIQIMEVE PUBLIKE	23,473.30
87985 SANIMI REGULLIMI UJSJELLESIT	12,820.62
87990 FURNIZIMI ME ELEMENTE BETONI DHE ZHAVOR	7,661.87
87998 NDERTIMI DHE MEREMETIMI I TROTUAREVE NE KOMUNE	25,000.00
40903 KRIJIMI I HAPSIR.TE GJELBRUARA	14,333.30
40923 RREGULLIMI I VARREZAVE SUHAREKE, DOBERDELAN	4,797.10
40937 NDERTIMI INFRASTRUKTURES NE ZONEN INDUSTRIALE	14,312.39
43513 RREGULLIMI I SHTRATIT TE LUMIT NE MUSHTISHT- LAGJJA E EPËRME	1,015.30
43525 RREGULLIMI I VARREZAVE NE KOMUNE (NEPERBISHT,SUHAREKE)	5,007.80
43550 NDERTIMI I RRUGES DHE KANALIZIMIT TE SHKOLLA NE VRANIQ	2,994.50
43554 NDERTIMI I RRUGES "BAFTI KODRA" NE KRUSHICEN E EPERME	1,528.14
87975 MEREMETIMI DHE NDERTIMI I KANALIZIMEVE	8,070.80
87983 NDERTIMI I RRUGES BRIGADA 123 SUHAREKE	10,007.00
88002 NDERTIMI I RRUGES NE BUKOSH REQAN	26,302.00

47012 BUJQËSIA - SUHAREKË	4,962.61
30 PASURITË JOFINANCIARE	4,962.61
85712 FONDI EMERGJENT PER MBROJTJEN E KULTURAVE BUJQESORE	0.00
40953 NGRITJA E SERAVE	2,111.23

85012 SHËRBIMET KULTURORE-SUHAREKË	15,059.08
30 PASURITË JOFINANCIARE	15,059.08
40962 NGRITJA E KAPACITETEVE PER KESHILLIN E VEPRIMIT RINOR	5,000.00
40961 RREGULLIMI I AMBIENTIT PER TRASHEGIMI KULTURORE	2,859.08
44504 NDERTIMI I STADIUMIT TE QYTETIT	7,200.00

66365 PLANIF.URBAN.INSPEKC-SUHAREKË	35,029.07
30 PASURITË JOFINANCIARE	35,029.07
43563 HARTIMI I PROJEKTEVE	0.00
85723 HARTIMI I PLANIT RREGULLATIV	0.00
89823 HARTIMI .HARMONIZIM I DOKUMENTAVE PLAN.HAPSIN.	0.00

73750 SHËR. E KU. PRI. SHË.SUHAREKË	679.23
30 PASURITË JOFINANCIARE	679.23
88026 SANIMI DHE RENOVIMI I QKMF-QMF	0.00

92060 ADMINISTRATA-SUHAREK	15,642.87
30 PASURITË JOFINANCIARE	15,642.87
44607 RREGULLIMI I OBORRIT TE SHKOLLES NE STRAVUQINE	15,642.87

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 4

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendim i njejtë do të shërbejë për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të mbetura pa u shfrytëzuar nga viti 2016 dhe viti 2017, e të cilat do të shfrytëzohen dhe shpenzohen në vitin fiskal 2018.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

Kryesuesi i Kuvendit

01-Nr-_____

Më datë _____

Bexhet KUÇI